



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT PËR
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 4/2013**

6 nëntor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, në vijim:

- 1. Rregullore për zbatimin e Shtojcës 11 të Konventës Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet e Trafikut Ajror**
- 2. Rregullore për zbatimin e Shtojcës 15 të Konventës Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet e Informimit Aeronautik**

Këto projekt-rregullore kanë qenë në procedurë të konsultimit publik nga data 18 tetor-5 nëntor 2013. Marrja e komenteve dhe vërejtjeve të palëve të interesit për këtë projekt-rregullore është bërë duke aplikuar procedurën e paraparë në nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.1/2012 (konsultimi me shkrim) duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar kushtet për organizimin e takimit me palët e interesit, siç parashihet me nenin 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012.

Thirrja për konsultim publik të palëve të interesit i është dërguar të gjithë hisedarëve në industrinë e aviacionit civil, duke përfshirë ANP "Adem Jashari" dhe institucioneve aeronautike të Republikës së Kosovës, dhe më gjerë.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

- Rregullore për zbatimin e Shtojcës 11 të Konventës sw Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet e Trafikut Ajror

Është hartuar në bazë të nenit 3.4 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, me qëllim të zbatimit të kërkesave dhe standardeve të ONAC-së, Shtojca 15 për shërbimin e trafikut ajror.

Komente:

Nuk ka

- Rregullore për zbatimin e Shtojcës 15 të Konventës sw Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet e Informimit Aeronautik

Është hartuar në bazë të nenit 3.4 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, me qëllim të zbatimit të kërkesave dhe standardeve të ONAC-së, Shtojca 11 për shërbimin e informimit aeronautik.

Komente:

Nuk ka

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloret nën pikën I të këtij raporti, nuk janë pranuar vërejtje/komente.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti për shërbimet e navigacionit ajror
Zyra për çështje juridike dhe rregullatore